

V E N D I M

Nr.400, date 19.8.1999

PER MIRATIMIN E KATEGORIVE TE LICENCIMIT DHE TE PROCEDURAVE PER APLIKIM PER LICENCE PER TE GJITHE PERSONAT FIZIKE DHE JURIDIKE, QE USHTROJNE APO DO TE USHTROJNE VEPRIMTARITE E GRUMBULLIMIT, TE TRAJTIMIT DHE TE SHPERNDARJES SE UJIT PER KONSUM PUBLIK, SI DHE TE LARGIMIT TE PERPUNIMIT TE UJERAVE TE NDOTURA

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te pikes 2 te nenit 17 te ligjit nr.8102, date 28.3.1996 "Per kuadrin rregullator te furnizimit me uje dhe te largimit dhe perpunimit te ujerave te ndotura", me propozimin e Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit,

KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

I.Miratimin e kategorive te licencave per personat fizike dhe juridike, qe ushtrojne apo do te ushtrojne veprimtarite e grumbullimit, te trajtimit dhe te shperndarjes se ujit per konsum publik, si dhe te largimit e te perpunimit te ujerave te ndotura, si me poshte:

- a. licence per grumbullimin dhe shperndarjen e ujit per konsum publik;
- b. licence per trajtimin e ujit;
- c. licence per largimin e ujerave te ndotura.

II. Miratimin e pcedurave te aplikimit per licence, qe autorizon nje person fizik apo juridik, i cili ushtron apo do te ushtroje veprimtarite e grumbullimit, te trajtimit dhe te shperndarjes se ujit per konsum publik, si dhe te largimit e te perpunimit te ujerave te ndotura, si me poshte:

A) Licence qe autorizon nje person fizik te ushtroje veprimtarine e grumbullimit, te trajtimit dhe te shperndarjes se ujit per konsum publik apo te largimit e te perpunimit te ujerave te ndotura.

1.Kerkese me shkrim per aplikim per licence, e cila te perfshije:

- a) Pervojen e personit fizik, i cili te kete te pakten 10 vjet pervojje pune ne drejtimin e njerës prej veprimtarive te grumbullimit, te trajtimit apo te shperndarjes se ujit per konsum publik apo te largimit e te trajtimit te ujerave te ndotura;
- b) llojet e veprimtarise qe kerkon te kryeje;
- c) veprimtaria e punes qe ka kryer deri ne tashmë e kerkeses.

2.CV-ne e personit fizik.

3.Dokumentin e diplomes, i cili te deshmoje se personi ka profil hidroteknik.

4.Dokumentin nga punedhenesi per periudhen qe ka punuar dhe punen e kryer.

5.Deshmi penaliteti (gjkate, prokurori).

B) Licence qe autorizon nje person juridik te ushtroje veprimtarite e grumbullimit, te trajtimit dhe te shperndarjes se ujit per konsum publik apo te largimit e te perpunimit te ujerave te ndotura.

1.Kerkese me shkrim per aplikim per licence, e cila te perfshije:

- a) pervojën e personit juridik, i cili te kete te pakten 10 vjet pervojje pune ne drejtimin e njerës prej veprimtarive te grumbullimit, te trajtimit apo te shperndarjes se ujit per konsum publik apo te largimit e te trajtimit te ujerave te ndotura, ku kerkon te ushtroje veprimtarine;
- b) llojet e veprimtarise qe kerkon te kryeje;
- c) veprimtaria e punes qe ka kryer nga krijimi i shoqerise deri ne tashmë e kerkeses;

d) pershkrimi i zones qe personi juridik ka nen juridiksion per kryerjen e veprimtarise se tij, si dhe harta e zones.

2.CV-ne e drejtuesit teknik, i cili te kete licencen qe autorizon nje person fizik te ushtroje veprimtarine e grumbullimit, te trajtimit dhe te shperndarjes se ujit per konsum publik apo te largimit e te perpunimit te ujerave te ndotura.

3.Autorizimin nga pronari, i cili i jep personit juridik te drejten per te kryer njerën nga veprimtarite e cilesuara ne ligj.

4.Deshmi penaliteti (gjykate, prokurori), per drejtuesin ligjor dhe teknik.

5.Kopjen e dokumentit te regjistrimit te personit juridik ne gjykate.

6.Dokumentin qe verteton se personi juridik ka shlyer detyrimet financiare ndaj shtetit deri ne datën e paraqitjes se kërkeses per marrje licence.

7.Lejen higjieno-sanitare nga Inspektorati Sanitar Shteteror i rrethit.

8.Lejen nga agjencia rajonale e mbrojtjes se mjedisit.

9.Deklaraten me shkrim, te personit juridik qe paraqet kërkesen, se me marrjen e licences do te zbatoje aktet ligjore e nenligjore, te nxjerra nga ERRU-ja, lagjislacionin shqiptar ne fuqi, standardet shqiptare per ndertimin dhe pajisjet qe do te perdoren ne ndertimin e veprave ujesjellese dhe kanalizimet.

III. Ngarkohet ERRU-ja per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko